

# RELACION

## PËR

### AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.97/2023 “PËR BUXHETIN E VITIT 2024””

#### **A. MËNYRA E NDËRHJRJES**

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23 datë 16.4.2014 etj.

Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet, si më poshtë vijon<sup>1</sup>:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

#### **1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:**

Neni 101 ka parashikuar ‘nevojën’ dhe ‘urgjencën’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave, pas vlerësimit përmbyllës në nivel vjetor të treguesve fiskalë 2023, si edhe në dritën e ndryshimeve më të fundit gjatë muajit janar të kabinetit qeveritar, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të parë të buxhetit për vitin 2024.

Ky rishikim ka për qëllim primar reflektimin në buxhetin vjetor të riorganizimit të ministrive të reja, sipas fushave të përgjegjësisë funksionale përkatëse. Kjo, krahas disa rishikimeve në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të cilat synojnë përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit të vitit 2024.

Në këtë kontekst, është me rëndësi të nënvizojmë se të gjitha ndryshimet që propozohen mbështeten në një sërë faktorësh realë dhe projeksionesh të

---

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

prishme, të cilat garantojnë zbatueshmërinë e tij. Kështu, është thelbësore të përmendim faktin se zhvillimet makrofiskale dhe buxhetore që shoqëruan mbylljen e vitit buxhetor 2023, u karakterizuan në shkallë të gjerë nga përmirësime të ndjeshme të parametrave të konsoliduar kyç, të cilët vijuan trendin pozitiv edhe përgjatë fillimtvitit 2024, duke krijuar kësisoj besimin për vazhdimësinë e këtyre ritmeve edhe për pjesën tjetër të vitit 2024. Ndër të tjera, vlen për t'u veçuar se:

- Ekonomia në tërësi gjatë vitit 2023 vazhdoi rritjen duke treguar një stabilizim të aktivitetit ekonomik. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për nëntëmujorin 2023 ka shënuar rritje prej rreth 3.3% krahasuar me nëntëmujorin 2022, sipas vlerësimit më të fundit të disponueshëm. Kjo rritje u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet, ku rritja shënoi, përkatësisht, vlerat 3.9% dhe 6.7%.
- Të ardhurat e përgjithshme gjatë vitit 2023, por veçanërisht gjatë tremujorit të fundit të tij, rezultuan më pozitive në arkëtime dhe, për rrjedhojë, programi i të ardhurave tatimore dhe kontributeve u tejkalua me 7.4 miliardë lekë ose 101.3% krahasuar me planin fillestar 2023. Të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (përfshirë edhe kontributet), u realizuan në masën 561.7 miliardë lekë, që përbëjnë rreth 52.3 miliardë lekë ose 10.3% më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit pararendës. Ndërkohë, të ardhurat totale për 12M 2023 ishin 643.4 miliardë lekë, 70.6 miliardë lekë ose 12.3% më shumë se 12M 2022.
- Borxhi publik në fund të vitit 2023 shënoi nivelin 59.2% të PBB-së, duke u ulur me 5.2pp krahasuar me fundin e vitit 2022. Ky nivel, i cili është konsiderueshëm më i ulët edhe krahasuar me periudhën para pandemisë (65.8% të PBB-së në vitin 2019), shënon njëkohësisht edhe nivelin më të ulët të regjistruar që prej vitit 2010 (57.7% të PBB-së).
- Deficiti buxhetor në fund të vitit 2023 shënoi nivelin prej 1.4% të PBB-së.
- Balanca primare në fund të vitit 2023 u rikthye për herë të parë në pozicion pozitiv prej rreth 0.7% të PBB-së që prej para pandemisë. Në vitin 2019 u regjistrua për herë të fundit një nivel pozitiv i balancës primare, prej rreth 0.2% të PBB-së.

## **2. Përkohshmëria**

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i

Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

## **B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTLIGJI**

Ky rishikim i buxhetit 2024, i cili propozohet t'i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, parashikon:

- reflektimin në të ardhurat e përgjithshme të tepricës prej 7.9 miliardë lekësh që i korrespondon rezultatit të akumuluar financiar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si edhe rritjen me 2.8 miliardë lekë të nivelit të planifikuar të të ardhurave tatimore;
- rritjen me 6.7 miliardë lekë të shpenzimeve buxhetore;
- reduktimin me 4 miliardë lekë të deficitit buxhetor;
- rritjen me 4 miliardë lekë të stokut të pritshëm të garancive në fund të vitit 2024, në kuadër të politikës së qeverisë për mbështetjen me garanci shtetërore të huas për bizneset private në sektorin e industrisë përpunuese.

## **C. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTLIGJI**

### **NË KAHUN E TË ARDHURAVE:**

- **Të ardhurat tatimore** rriten në masën 2.8 miliardë lekë, bazuar në performancën e vjeljes së tyre në buxhetin 2023 të sapombyllur. Kjo performancë ka vijuar të jetë pozitive edhe përgjatë muajit janar 2024, duke krijuar kështu besimin e justifikuar për vazhdimësinë e këtyre ritmeve edhe për pjesën tjetër të vitit 2024 dhe rrjedhimisht propozimin për përditësimin në rritje të planit vjetor të tyre në këtë akt normativ. Më konkretisht:
  - Projektioni i të ardhurave të vitit 2024 u bazua në rezultatet e arkëtimit të tyre për 9-mujorin 2023. Ndërkohë që, rezultati i fundvitit në arkëtimin e të ardhurave dhe kontributeve shënoi një tejkalim me 7.4 miliardë lekë krahasuar me planin fillestar 2023. Programi i të ardhurave tatimore të muajit janar 2024 rezulton me një tejkalim prej 0.5 miliardë lekësh kundrejt planit, çka konsolidon besimin për realizimin dhe tejkalimin e të ardhurave të programuara me buxhetin fillestar 2024, duke mbështetur kështu rritjen e propozuar të tyre në këtë akt normativ.

- Nga ana tjetër, janë ndërmarrë ndryshime ligjore në fushën e turizmit për kategorizimin e strukturave turistike dhe përcaktimin e kapaciteteve minimale të shfrytëzimit, me qëllim disiplinimin e ofrimit të shërbimeve të akomodimit në kushtet kur pritshmëritë në këtë sektor janë për një rritje të mëtejshme.

Pas ndryshimeve të propozuara, të ardhurat e buxhetit 2024 programohen të arrijnë nivelin 686.8 miliardë lekë ose 28.2% të PBB-së.

- **Rezultati i akumuluar financiar i ISSH-së** prej 7.9 miliardë lekësh reflektohet si shtesë në zërin e të ardhurave jotatimore. Performanca e realizimit të kontributeve për vitin 2023 arriti nivelin më të lartë të regjistruar për këtë tregues, prej 6.3% të PBB-së. Në të njëjtën kohë, deficiti i skemës së pensioneve u ul në nivelin 0.8% të PBB-së, me një rënie të ndjeshme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, nga rreth 2% e PBB-së në vitin 2013. Më konkretisht:

- Shuma prej 7.9 miliardë lekësh përbën rezultatin financiar të akumuluar të ISSH-së, të krijuar si rrjedhojë e tejkalimit të të ardhurave kontributive dhe transfertës buxhetore të miratuar në ligjin e buxhetit përkatës. Mbështetur në nenin 2 të ligjit të buxhetit 2024, rezultati financiar i akumuluar i ISSH-së do të transferohet në buxhetin e shtetit, pasi është plotësuar rezerva ligjore e skemës.
- Gjithashtu, në vitet e fundit ecuria e mbledhjes së të ardhurave kontributive ka qenë progresivisht pozitive duke gjeneruar tejkalim të tyre e, rrjedhimisht, nuk ka qenë i nevojshëm përdorimi i rezultatit financiar për mbulimin e shpenzimeve të skemës.
- Vlen të theksohet se si rezultat i performancës në mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore, është përmirësuar ndjeshëm (në ulje) edhe niveli i transfertës së buxhetit të shtetit për skemën e sigurimeve shoqërore, i cili nga mesatarisht 36% e totalit të shpenzimeve në vitet 2018-2022 ka rënë në rreth 27% të tyre në vitin 2023. Ky nivel projektohet në trend rënës edhe për periudhën në vazhdim, nisur nga politika e rritjes së pagave në sektorin publik, që ka sjellë edhe rritje në sektorin privat.

## **NË KAHUN E SHPENZIMEVE:**

Propozimet sa u takon zërave të shpenzimeve buxhetore konsistojnë kryesisht në:

- Ndarjen institucionale dhe buxhetore mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në zbatim të

vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.30 dhe nr.31, datë 17.1.2024, të cilat kanë përcaktuar fushat e reja të përgjegjësive funksionale përkatëse.

- Mbështetjen e ministrit të ri të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, duke siguruar të gjithë logjistikën e nevojshme për këtë qëllim, në drejtim të plotësimit me organikë dhe fonde buxhetore për vitin 2024.
- Instrumentin e garancisë së re shtetërore prej 4 miliardë lekësh në mbështetje të bizneseve private të sektorit të industrisë përpunuese, të cilat kanë nevojë të përmirësojnë dhe të përditësojnë proceset teknologjike që përdorin dhe të rrisin nivelin e produktivitetit e konkurrueshmërisë në tregjet ndërkombëtare, për të përballuar efektet e krizave që kanë ndikuar në ambientin e brendshëm e të jashtëm. Në këtë kontekst, ky instrument synon mbështetjen e këtij sektori nëpërmjet garancisë shtetërore të huasë me qëllim sigurimin e financimit të nevojshëm nga bankat e nivelit të dytë. Specifikat e instrumentit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Riklasifikimin e projektit të ‘Portit të ri tregtar - Porto Romano, Durrës’, si investim me financim të brendshëm. Për këtë projekt, i cili në ligjin fillestar të buxhetit 2024 ishte planifikuar me financim të huaj, është kërkuar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të financohet me burime të brendshme, përkatësisht në vlerën 9.8 miliardë lekë (me TVSH) për vitin 2024 dhe nga 14.7 miliardë lekë për secilin vit buxhetor 2025-2026. Argumentet në mbështetje të këtij ndryshimi lidhen kryesisht me rëndësinë strategjike të këtij projekti madhor i cili përmbush standardet ndërkombëtare, teknologjikisht të përparuara dhe ekologjike, të cilat do të garantojnë plotësimin e kërkesave të Shqipërisë dhe vendeve të Rajonit sa i takon transportit detar. Ai do të krijojë një hapësirë logjistike, që do të shërbejë si qendër për rritjen e mëtejshme ekonomike për zonën Tiranë - Durrës dhe trajtimin e ngarkesave tranzit në port. Porti i ri tregtar do të vendosë Shqipërinë si nyje në rrjetet infrastrukturore rajonale, duke sjellë rritje dhe përmirësime në aspektin e zhvillimit ekonomik e social të vendit. Rrjedhimisht, financimi i një projekti të tillë me mbështetje të drejtpërdrejtë buxhetore siguron përshpejtimin e procedurave të domosdoshme për fillimin dhe avancimin e punimeve, krahas mbikëqyrjes nga ana e strukturave shtetërore për mbarëvajtjen e procesit.
- Financimin e Strukturës së re të Posaçme (Task-Forcë) me 48 punonjës, të ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK) në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të aktit normativ nr.8, datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente, për

mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”.

Nevoja lindi për shkak të situatës emergjente mjedisore të krijuar nga subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe shkarkojnë ujërat e ndotura në ujëra larëse, pa i trajtuar sipas standardeve. Task-Forca e krijuar në varësi të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, parashikohet të financohet me fonde buxhetore, me qëllim sigurimin e mbështetjes së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së saj në drejtim të monitorimit, inspektimit dhe marrjes së masave administrative të nevojshme për disiplinimin e shkarkimit të ujërave të ndotura, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Financimin e projektit të përmirësimit të kushteve të konvikteve në arsimin e mesëm profesional, përkatësisht për qarqet Tiranë, Vlorë, Shkodër, Dibër dhe Elbasan. Rikonstruksioni/ndërtimi i godinave të konvikteve në vlerën 400 milionë lekë për vitin 2024 parashikohet të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
- Financimin e një pjese të projektit pilot ‘Zhvillimi i integruar i burimeve ekonomike, natyrore dhe social-kulturore, Bashkia Divjakë’, në vlerën 128 milionë lekë për vitin 2024. Ky fond, i cili do t’i alokohet Bashkisë Divjakë si transfertë specifike do të shërbejë për të siguruar flotën e nevojshme të makinerive të rënda me qëllim realizimin e punëve publike, në kuadër të menaxhimit të infrastrukturës së zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit në këtë bashki.

## **NË ASPEKTIN E DEFICITIT DHE BORXHIT PUBLIK:**

- Deficiti buxhetor, për rrjedhojë të ndryshimeve të sipërpërmendura në të ardhura dhe shpenzime, reduktohet me 4 miliardë lekë.
- Borxhi publik për buxhetin 2024 rishikohet, duke reflektuar ndryshimet, si vijon:
  - Financimi i projekteve me kredi të huaj, ulet me 4 miliardë lekë.
  - Financimi nëpërmjet kredive të huaja në formën e mbështetjeve buxhetore, rritet me rreth 5.5 miliardë lekë, duke reflektuar disbursimin e një kredie me terma të butë për mbështetje buxhetore nga KfË për reformën në sektorin e energjisë, e cila nuk u disbursua gjatë vitit 2023.
  - Rritet stoku i pritshëm i garancive në fund të vitit 2024 me 4 miliardë lekë, në kuadër të politikës së qeverisë për mbështetjen me garanci

shtetërore të huas për bizneset private në sektorin e industrisë  
përpunuese.

Ndryshimet e propozuara në këtë akt normativ do të vijojnë të garantojnë trajektoren rënëse të nivelit të borxhit publik në raport me PBB-në, në përputhje me rregullin përkatës fiskal të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit, duke siguruar kështu vijimësinë e konsolidimit fiskal dhe qëndrueshmërisë afatmesme e afatgjatë të financave publike dhe stabilitetin makroekonomik në tërësi.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**